

Duke u bazuar në nenin 3, paragrafi 1.3, nenin 5 të ligjit Nr. 06/ L- 092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale dhe Rregullorës QKR Nr. 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, Komisioni Vlersues për dhënjën në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës se Pejës me dt.27.06.2020 shpallë:

ANKAND PUBLIK

Për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Afatëshkurtër

Ftohen të gjithë personat fizik dhe juridik që janë të interesuar për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të Komunës e cila gjëndet në Pejë, të aplikojnë në ankandin publik duke respektuar procedurën si më poshtë:

Ipet në shfrytëzim prona e paluajtshme komunale ku përfshihet hapsirat në objektet që janë në shfrytëzim nga Komuna – objektet e Administratës komunale,

1. Objekti qendror i administratës,
2. Objekti i sallës së Kuvendit Komunal,
3. Objekti i Drejtorisë së Kadastrit etj,
4. Objekti i Drejtorisë së Arsimit etj. dhe
5. Objekti i QKMF-së, të gjitha këto objekte janë në ngastrat të regjistruara si Pronë Shoqërore e KK Pejë.

Hapsirat në këto Prona të paluajtshme të ofruara në ankand ipen me qëllim që të vendosen aparatet mobile automatike për shërbimin e kafesë dhe aparatet mobile automatike për shërbimin e ushqimit dhe pijeve.

- Çmimi fillestar për dhënien e këtyre hapsirave të pronës publike është 10 € për një muaj për 1 m² të shfrytëzimit.
- Përzgjedhja e fituesit bëhet në bazë të çmimit më të lartë të ofertuar në ankand publik.
- Afati i dhënies në shfrytëzim është afatshkurtër 5 (pes) vite.
- Prona e dhënë përmes ankandit publik do të shfrytëzohet në veqanti vetëm për aparatet mobile automatike për shërbimin e kafesë dhe aparatet mobile automatike për shërbimin e ushqimit dhe pijeve.
- Ofertat mund të dorëzohen duke filluar nga data e publikimit të ankandit publik. Afati i fundit për dorëzimin e ofertës do të jetë gjer me dt.06.07. 2020 në ora 16;00.
- Hapja e ofertave do të bëhet nga Komisioni Vlersues komunal për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale në prezencë të ofertuesve me dt.07.07.2020 në ora 11;00. Hapja e ofertave bëhet në sallën e Kuvendit.
- Ankandi publik do të mbahet përmes ofertave të mbyllura.
- Personi kontaktues Zyrtari Ligjor për çështje pronsoro-juridike tel. Zyrtar 03820043477, e-mail, nga ora 08;00 – 16;00
- Formulari dhe dokumentacioni ofertues për të konkuruar në ankand mund të merret në formë fizike në zyrën nr. 17 dhe atë elektronike në faqen e Komunës **zip-peje@hotmail.com** Pejë.

Përsonat të cilët aplikojnë në ankandin publik për marrjen e pronës në shfrytëzim duhet të prezantojnë këto dokumenta shtesë:

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit (duke përfshirë numrin fiskal)
- Certifikatën e TVSH-së,
- Vërtetimin e tatimit në pronë,
- Të jetë i licencuar për ofrimin e produkteve të kërkuara,
- Të ketë licencë për prodhimin e kafesë dhe ofrimin e shërbimeve tjera,
- Të ketë Certifikatën e kualitetit të produkteve,

Dokumentacioni dhe kriteret e kërkuara për aparatin e kafesë dhe aparatin e ushqimit dhe të pijeve do të specifikohen në dokumentacionin e dosjes së ankandit publik.

Informatat shtesë dhe vizitat për shikimin e objektit mund të bëhen gjatë gjithë periudhës së ankandit publik duke ju referuar zyrës së Drejtoratit për Çështje Pronsoro-Juridike

Ofertat e mbyllura duhet të dorëzohen në afatin e lartëcekur në zyrën e Drejtorisë për Çështje Pronsoro-Juridike.

Ofertat duhen të jetë në origjinal me 1 (një) kopje shtesë.

Të gjitha të drejtat dhe obligimet që dalin nga ky ankand publik përcaktohen me kontratë në mes të Komunës dhe fituesit në ankandin publik.